



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 874/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Bardh Morina, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si të pabazuar apelin e parashtruar nga Bardh Morina, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me shenjën ZL.Anr.874/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.874/2017 me datën 10.11.2017, nga parashtruesi i apelit Bardh Morina, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilin thekson se ka pasur keqpërdorim të votave, në këto Qendra të Votimit: 2513d në Talinoc Muhaxherëve, 2529d në Mirosadë, 2502d “Gjon Serreçi”, 2532d Ternë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërinë e apeleve si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apeluesit gjeti se apeli është i pabazuar sepse nuk është specifikuar Vendvotimi i saktë në Qendra të Votimit ku kanë ndodhur parregullsitë, dhe me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të

përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si tillë apeli u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.874/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi e Panelit

Zyhdi Haziri



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*